



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 156 /2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër Hasan Reka simpatizant i subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit në raundin e dytë të zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 30.05.2012, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 28.05.2012, nga subjekti politik LDK , me të cilën pretendohet se Hasan Reka nga Nerodimja e Epërme është zënë duke votuar për të dytën herë në vendvotimin nr. 4. Parashtruesi i ankesës thekson se ka pasur edhe parregullsi të tjera që kanë ndikuar në rezultat dhe për këtë arsye kërkon anulimin e votimit në këtë vendvotim.

Në deklaratën e Urim Bajramit - komisioner VV 2505d/04 të dorëzuar më shkrim në PZAP theksohet ne ora 10:00 ka ardhur, Hasan Reka, ka votuar dhe te gjithëve na ka treguar fletëvotimin me te cilin dëshmonte se ka votuar për Agim Aliun Kandidat për kryetar komuna në Ferizaj, nga subjekti politik PDK, pastaj ka ardhur prapë Hasan Reka rreth orës 16:30 dhe ka votuar përsëri. Ne intervenimin e këtij komisionerit tek kryesuesi i VV 2505d/04, lartpërmenduri te mos lejohet te votoj ai mu pergjigj se ai nuk ka nënshkruar ne Librin e Votimeve; pas kontrollimit nga ana e deklaruesit ne listën e votimeve nënshkrimet ishin te vena te vëllait te tij ,z.Hazir Reka i cili jeton ne Prishtinë dhe atë ditë ai nuk ka qenë për të votuar. Gjithashtu, në librin e votimeve, ishte edhe nënshkrimi i z,Gjevat Reka,vëllait të lartpërmendurit, i cili jeton ne Gjermani dhe ditën e votimeve nuk ka qenë në vendvotim për të votuar. Pas gjithë kësaj tollovie që e ka bërë ai, ka ardhur dhe më ka thënë ne vesh "mos e ban më të madhe se ja kam premtuar Agim Aliut këto vota për shpirt të tij". Për të gjitha këto votime të jashtëligjshme ka qenë i njoftuar Kryesuesi i Vendvotimit z. Bekim Rexhepi

PZAP-i kërkoj deklaratë me shkrim nga kryesuesi i VV Bekim Rexhepi dhe nga të gjithë komisionerët e VV nr. 4 në fshatin Nerodime - Ferizaj dhe poashtu PZAP-kërkoj nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) – Qendëra e Numrimit të Rezultateve (QNR) materialin e nevojshëm për hetim lidhur me VV 2505d/04.

PZAP-i për të vërtetuar në mënyrë të drejtë çështjen faktike, administroi provat që gjenden në shkresat e lendes si: pretendimet ankimore, deklaratën e kryesuesit të VV VV 2505d/04 dhe të gjithë komisionerëve në VV e sipërshënuar, Listën përfundimtare të votuesve, Librin e votimit si dhe Formularin e Përputhjes së Rezultateve (FPR), gjeti se ankesa është e pabazuar.

Nga deklarata e kryesuesit të VV 2505d/04 Bekim Rexhepi, vërtetohet se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore ngase në lidhje me ankesën e parashtruar për parregullsi gjatë ditës së votimit i ka pyetur të gjithë anëtarët e vendvotimit me radhë por askush nga ata si dhe nga vëzhguesit prezent në vendvotim nuk e pohojnë këtë shkelje dhe për këtë thekson se nuk ka pasur ndonjë parregullsi gjatë votimit personi në fjalë kishte hyre në mënyrë të rregullt kishte votuar dhe kishte dalë nga VV pa asnjë vërejtje nga askush, pos nga akuzuesi.

Nga deklaratat e Albert Kashtanjeva dhe Ramadan Maloku që të dy komisioner në VV 2505d/04 vërtetohet se personi në fjalë kishte votuar në mënyrë të rregullt si çdo votues i rregullt pa asnjë parregullsi.

Nga materiali i KQZ-së - QNR-së, vërtetohet e kundërta e pretendimeve ankimore, ngase Hasan Reka kishte votuar në mënyrë të rregullt në Listën Përfundimtare të Votuesve (LPV) ndërsa sa i për çështjes së Hazir Reka jeton në Prishtinë dhe kishte votuar dikush tjetër për atë nuk qëndron sepse në LPV në VV2505d/04 nuk ekziston ndonjë person me emrin Hazir Reka.

PZAP-i pas vlerësimit të gjitha provave të administruara dhe duke i marr parasysh të gjitha rrethanat konstatoi se në rastin konkret nuk ka pasur votim të dyfishit siç pretendohet në ankesë, po ashtu këtë e bënë edhe më bindëse vetë parashtruesi i ankesë ngase nuk i ka bashkangjitur asnjë provë ankesës si dëshmi bindëse të cilat do të argumentonin pretendimet e tilla ankimore, andaj duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lart e në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë*

është më e lartë sesa pesë mijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

A nr. 156 /2012 më datën 30.05.2012.

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha

